



## Koment i sures Ed-Duha

### Description

Fahrudin Razi

**“Betohem në shkëlqimin e paradites, dhe në natën kur terret e qetësohet.”** Surja el-Duha, 1-2.

Komentuesit e Kuranit japin dy shpjegime për fjalë ????? – *el-Duha*:

*I pari*: Fjala *el-Duha* vjen me kuptimin e paradites, pra është momenti kur dielli fillon të shfaqet në qiell dhe lëshon rrezet e tij.

*I dyti*: Fjala *el-Duha* vjen me kuptimin e ditës, gjë që e mbështet fakti se në ajetin pasardhës përmendet nata.

Për foljen ??? – *sexha* e përmendur në ajetin e dytë, gjuhëtarët kanë dhënë tre interpretime të cilat në fakt kanë kuptime të përafërta: qetesohem, errësoj dhe mbuloj. Pra arabët kur thonin natë *saxhije*, kishin parasysh natën e qetë pa erë, madje edhe kur thonë u qetësuan dallgët e detit përdorin të njëjtën folje, ??? – *sexha*.

Përdorimi i dytë i foljes ??? – *sexha* vjen me kuptimin errësoj, gjë të cilën e konfirmon gjuhëtari i famshëm el-Ferra.

Ndërsa përdorimi i tretë i foljes ??? – *sexha* vjen me kuptimin mbuloj, këtë gjë e konfirmon el-Esmaiu. Arabët thonë ??? ????? – *sexha el-lejl*, ra nata, pra që do të thotë mbuloi çdo gjë. Në këtë kontekst të tre kuptimet e foljes ??? – *sexha* duken të përafërta, sepse kur bie nata çdo gjë errësohet, pra bëhet e padukshme njësoj si të jetë e mbuluar, dhe kur bie nata njerëzit qetësohen, pra nuk ka ma lëvizje dhe gjallëri.

Megjithatë për përdorimin e dytë të foljes ??? – *sexha* ka dy shpjegime:

*I pari:* Nënkupton rënien e njerëzve në qetësi, siç thuhet; një natë e fjetur.

*I dyti:* Domethënë nata arrin kulminacionin e saj pra bëhet terr.

Dhe tani është momenti të bëj disa pyetje:

*Pyetja e parë:* Cila është arsyeja që në suren pararendëse Zoti e përmend natën para ditës ndryshe nga surja në fjalë? Do të përpiqem të jap disa përgjigje:

*E para:* Si nata ashtu edhe dita janë në funksion të njeriut për të përmbushur nevojat e veta, por nata ka një epërsi të lehtë le të themi duke qenë se shfaqet para ditës **“Qoftë lavdëruar Allahu që krijoj qiejt dhe Tokën dhe bëri errësirën dhe dritën.”** Surja el-En’am:1, po edhe dita ka avantazhin e saj sepse ajo është dritë, madje natën mund ta krahasoj me jetën e kësaj bote ndërsa ditën me jetën e Botës Tjetër, dhe përderisa si nata ashtu edhe dita kanë specifikat e veta, nuk ka asgjë të keqe që një herë të renditet njëra e para dhe një herë të renditet tjetra, madje një rast të ngjashëm e hasim edhe mes rukusë dhe sexhdes në Kuran. **“Bëj sexhde dhe përkulu në ruku”** thotë Zoti në Suren Al Imran, ajeti 43, duke renditur sexhden të parën, ndryshe është çështja kur bëhet fjalë për suren el-Haxh, sepse aty rukuja renditet e para para sexhdes në ajetin 77 **“Përkuluni dhe përluni në sexhde”**.

*E dyta:* Allahu e ka renditur natën para ditës në suren e Ebu Bekrit (d.m.th. Suren el-Lejl), sepse ky i fundit qe përfshirë në praktikat e kufrit para se të besonte, ndërsa këtu, pra në suren el-Duha, dita renditet para natës sepse Muhamedi nuk qe përfshirë kurrë në marrëzira të tilla.

*E treta:* Surja el-Lejl është e Ebu Bekrit, ndërsa surja el-Duha është e Muhamedit a.s. dhe jo pa qëllim Zoti zgjodhi të mos vendosë mes tyre sure tjetër sepse edhe ata të dy nuk kanë qenë kurrë të ndarë nga njëri-tjetri. Kështu që kur përmendet nata, pra Ebu Bekri, mjafton të ngjitesh pak dhe arrin ditën, pra Muhamedin, edhe anasjellas, në qoftë se lexon në fillim suren el-Duha, Muhamedin, mjafton të zbresësh pak dhe arrin tek el-Lejl, Ebu Bekri, që të kuptosh se mes tyre nuk ka ndarje.

*Pyetja e dytë:* Cila është urtësia e betimit veç në paradite dhe natë në këtë sure? Ja cilat do të ishin përgjigjet e mia:

*E para:* Le të themi se Zoti dëshiron të thotë; e tillë është natyra e kohës, ajo përbëhet nga orët, një herë merr nata nga dita dhe një herë dita nga nata, dhe ky fenomen nuk ndodh as për pasion as për urrejtje por me një urtësi, edhe shpallja zbrit apo ndërpritet për arsye të caktuara, sepse as zbritja nuk varet nga ndonjë pasion i fortë dhe as ndërpreja si pasojë e urrejtjes.

*E dyta:* Ne e dimë se fjala e dijetarit nuk lë gjurmë pa dhënë ai shembullin e vet, por megjithatë Allahu ka caktuar që provat detyrohet t'i paraqesë pala paditëse ndërsa pala e paditur mjafton të betohet, në këtë kuptim Muhamedi i detyroi të sjellin prova, politeistët të cilët pretenduan se Zoti e ka braktisur Muhamedin dhe e urren, gjë të cilën ata e kishin të pamundur, prandaj u betua se Zoti as nuk e ka braktisur dhe as nuk e urren.

*E treta:* Le të themi se Zoti e përdor natën dhe ditën të cilat në përpjekje të vazhdueshme marrin nga njëra-tjetra për t'i treguar Muhamedit se edhe njerëzit nuk do të reshtin së sulmuari.

*Pyetja e tretë:* Përse Zoti e specifikon paraditen në këtë ajet? Kësaj pyetje do t'i jap dy përgjigje:

*E para:* Sepse është koha kur njerëzit fillojnë të shoqërohen me njëri-tjetrin pasi nata i ndau dhe vetmoi, pra tani është momenti të gëzohesh sepse dëshpërimi që të shoqëroi me ndërprerjen e shpalljes do të zhduket me rifillimin e saj sapo të lindë dita.

*E dyta:* Kjo është koha që Musai foli me Zotin dhe momenti që magjistarët u lëshuan në sexhde, në këtë kuptim, vetë koha për këto arsye të veçanta ka marrë vlera të jashtëzakonshme, paramendo ata që kryejnë punë të mira gjatë kësaj kohe?! Dhe me siguri ai që e nderoi Musain nuk do të lërë pa të nderuar edhe ty. Ai që ndryshoi zemrat e magjistarëve sa u lëshuan me fytyrë përtokë do t'i ndryshojë edhe zemrat e armiqve të tu.

*Pyetja e katërt:* Cila është arsyeja që Zoti përmend paraditen e cila është një pjesë e ditës, ndërsa natën e përmend me term specifik? Edhe kësaj pyetje do t'i jap disa përgjigje:

*E para:* Ndoshta sepse një pjesë e ditës vlen sa e gjithë nata, njëjtë si Muhamedi që vlen sa të gjithë profetët.

*E dyta:* Paraditja është vakt për veprimtari dhe aktivitet, ndërsa nata është vakt vetmimi dhe mërzitnie, nga kjo kuptojmë se hallet e kësaj bote zgjasin më shumë se ditët e gëzueshme, me qenë se paraditja është një orë e caktuar ndërsa nata zgjat pa fund.

*E treta:* Vakti i paradites është kohë gjallërie, dhe në këtë kuptim përngjan me Ditën e Ringjalljes, ndërsa nata duke qenë se është vakt qetësie përngjan me jetën e varrit, sigurisht që si njëra ashtu edhe tjetra janë bekim dhe kanë urtësi, ama jeta vlen më shumë se vdekja, prandaj Zoti e rendit paraditen para natës.

*E katërta:* Paraditja paraqitet si prove që të mos e ndjejë dëshpërimin, ndërsa nata që të mos ndjehet i sigurtë prej kurtheve të saj.

*E pesta:* Madje kanë thënë se paraditja është personalifikim i fytyrës së Muhamedit, ndërsa nata i flokëve të tij. Disa të tjerë thonë se paraditja evokon shpalljen, ndërsa nata ndërprerjen e saj, sepse ndërkohë që shpallja zbriste Muhamedi ndjehej i lumtur, në momentin që u ndërpre ndjeu vetminë. Thuhet gjithashtu se paraditja evokon revanshin e Islamit pasi që i panjohur, ndërsa nata faktin se ai do të rikthehet sërish siç filloi. Paraditja interpretohet gjithashtu si kulminacioni i intelektit ndërsa nata si vdekja. Dhe e fundit, betohem për paraqitjen tënde që s'ka asnjë cen, dhe të brendshmen që edhe i Dituri i fshehtësive e di që s'ka asnjë të metë.

**“se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren!”** Surja el-Duha:3.

*Ky ajet përfshin disa çështje:*

*E para:* Folja ??? – *ved-dea* shpreh një veprim me intensitet të lartë, sepse ajo nuk është një folje e thjeshtë por e përbërë, dhe do të thotë lamtumirë, ndërsa folja ??? – *kala* do të thotë urrejtje.

*E dyta:* Xhebraili e vonoi shpalljen gjë që shtyu politeistët të thonë se Zoti është zemëruar me të dhe e ka braktisur, dhe pikërisht për këtë arsye Allahu shpalli këtë ajet.

el-Sedi thotë se Xhebraili e vonoi dyzet netë shpalljen, kjo gjë e shqetësoi profetin prandaj mori t'i ankohet Hatixhesë, ndërsa ajo i tha, ndoshta Zoti të ka harruar a të ka braktisur.

Tregohet gjithashtu se Umu Xhemil, bashkëshortja e Ebu Lehebit iu drejtua profetit me këto fjalë: O Muhamed mendoj se djalli yt të ka braktisur.

Ndërsa el-Hasen ka thënë: Profetit iu ndërpre shpallja një farë periudhe dhe mori t'i ankohej Hatixhesë dhe i tha: Zoti im është zemëruar me mua dhe më braktisi. Kurrë! Beto hem për atë që të shpalli të vërtetën, Zoti mori të nderojë dhe do ta plotësojë këtë dhunti, -ia ktheu ajo, pastaj u shpall ajeti kuranor **“se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren!”**

Dijetarët e hadithit i kritikojnë fort këto transmetime, sepse nuk i shkon përshtat një profeti të ankohet dhe mendojë keq për Zotin e tij, madje profetët e dinë më mirë se kushdo tjetër se profecia nuk revokohet, sepse urtësia e Zotit nuk e toleron një sjellje të tillë, sepse profecia ndodh kur piqen kushtet, në këtë kuptim çfarë treguam më lart nuk mund të jenë fjalët e profetit.

Megjithatë dijetarët kanë mendime të ndryshme sa i takon kohëzgjatjes së ndërprerjes së shpalljes. Ibn Xhurejxh përshembull mendon se ka zgjatur dymbëdhjetë ditë, el-Kelbi pretendon se ka zgjatur pesëmbëdhjetë ditë, ndërsa ibn Abasi njëzet e pesë ditë. El-Sedi dhe Mukatil thonë dyzet ditë. Gjithashtu dijetarët paraqesin arsye të ndryshme të shkakut të ndërprerjes së shpalljes, por shumica e tyre tregojnë se arsyeja e ndërprerjes së shpalljes është një ngjarje mes profetit dhe disa hebrenjve, këta të fundit i drejtuan tri pyetje; çfarë është shpirti? kush është Dhu el-Karnejni? dhe kush janë djemtë e shpellës? Profeti tha se do t'ju kthej përgjigje nesër, por shpallja u ndërpre për një farë kohe.

Ibn Zejd thotë se arsyeja e ndërprerjes së shpalljes qe një qenush i Hasanit dhe Hysenit i cili kishte hyrë në shtëpinë e profetit a.s. Xhebraili e qortoi dhe tha ne nuk futemi në një shtëpi në qoftë se ka qen a figura brenda saj.

Të gjitha transmetimet e mësipërme konsiderojnë se ndërpreja e shpalljes erdhi si shkak i urrejtjes, por kjo nuk është aspak e vërtetë, maksimumi që mund të themi është se kjo qe gjëja e duhur, përndryshe Zoti as nuk e braktisi as nuk e urreu Muhamedin. Tregohet se profeti a.s. i tha Xhebrailit: U vonove tepër sa më mori shumë malli. Unë kisha edhe më shumë mall për ty, -ia ktheu Xhebraili, por mua më është ngarkuar një detyrë që duhet ta zbatoj dhe këndoi këtë ajat kuranor “Ne (engjëjt) zbresim vetëm me urdhrin e Zotit tend” Surja Merjem:64.

Nuk është aspak e hijshme për Zotin t'i thotë krijesës që e do më shumë Unë nuk të urrej në shenjë nderimi. Pra kjo është një sjellje e papërshtatshme në qoftë se nuk ekziston një arsye fillestare, por rasti për të cilin po flasim ndryshon, sepse armiqt e Muhamedit vendosën në gojën e Zotit një pohim të pavërtetë, në këtë kuptim shfajësimi i Zotit, Unë nuk të kam braktisur dhe as të urrej, është kulminacioni i nderimit.

*Çështja e tretë:* Kjo ngjarje tregon se Kurani është fjala e Allahut, përndryshe nuk do të ndërpritej për një kohë të caktuar.

**“Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë”** Surja el-Duha:4.

Ky ajet ruan një lidhje logjike me ajetin e mëparshëm për disa arsye:

*E para:* Ne thamë edhe më lart se është e palogjikshme të ndërpritet shpallja sepse kjo do të nënkuptonte revokimin e profecisë, por maksimumi që mund të themi në këtë rast ndërprerja e shpalljes ndodhi si shenjë e përmbushjes së misionit në raport me shpalljen, në mënyrë indirekte kjo tregon se vdekja po afrohet, pra ndërprerja e shpalljes do t'i hapë rrugë vdekjes, por vdekja ama është më e mirë për ty, sepse çfarë të është rezervuar në Botën Tjetër është shumë herë më e mirë se çfarëdo që zotëroje në këtë jetë.

*E dyta:* Kur Zoti shpalli **“se Zoti yt nuk të ka braktisur”** kjo qe shenjë e një nderimi të madh, dhe me qenë se u duk se profeti i dha shumë rëndësi, Allahu shpalli ajetin vijues **“Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë”**, që do të thotë se edhe pse ky nderim që po të bëhet është i madh, duhet të kesh parasysh se çfarë të ka rezervuar Zoti në Botën Tjetër është edhe më e madhe dhe shumë herë më e mirë.

*E treta:* Çfarë më vjen ndërmend tani është të them se ajeti në fjalë paralajmëron se kushtet sociale në të ardhmen do të jenë shumë më të mira se ditët e shkuara, pra le të themi se Zoti i premtun se çdo ditë që kalon do të fuqizohet dhe do të fitojë pushtet, pra mos mendo se të kam braktisur, përkundrazi do të përkrah dhe çdo ditë e më shumë do të fitosh terren dhe do të bëhesh i rëndësishëm.

Tani është momenti të bëj dy pyetje:

*Pyetja e parë:* Cila është mënyra për të kuptuar se Bota Tjetër është më e mirë se kjo botë?

*E para:* Le të themi se Zoti dëshiron të thotë se ti ndjehesh mirë në këtë jetë sepse vepron atë që dëshiron, por Bota Tjetër do të jetë më e mirë sepse atje bëjmë Ne çfarë të duam.

*E dyta:* Bota Tjetër është më e mirë për ty sepse atje do të bashkohet i gjithë ymeti yt, sepse pjestarët e ymetit kanë vlerën e fëmijëve për të, prandaj Allahu thotë në Kuran: **“gratë e tij janë nënat e tyre”** Surja el-Ahzab:6, ndërsa ai është si një baba për ta, dhe në këtë kuptim pjestarët e ymetit të tij në xhenet do të jenë si fëmijët e tij, dhe fëmija është kënaqësia e syve, siç thotë Zoti në Kuran, në suren el-Furkan, ajeti 74 **“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”**.

*E treta:* Bota Tjetër është më e mirë për ty sepse ti e ke fituar atë, ndërsa kjo botë nuk të takon ty, por edhe nëse Bota Tjetër do të vlente më pak se kjo botë sërish do të ishte më mirë për ty, sepse çfarë është në pronësinë tënde është më e mirë se ajo që nuk e zotëron, megjithëse ne e dimë se Bota Tjetër nuk ka të krahasur me këtë botë.

*E katërta:* Bota Tjetër është më e mirë sepse në këtë botë qe i rrethuar nga mohues të cilët të akuzojnë, ndërsa në Botën Tjetër ymeti yt do të jetë dëshmitar për të gjithë popujt e tjerë, ndërsa ti do të jesh dëshmitar për të gjithë profetët, ndërsa Unë do të dëshmoj për ty **“Allahu mjafton si dëshmitar! Muhamedi është i Dërguar i Allahut.”** Surja el-Fet’h:28-29.

*E pesta:* Të mirat e kësaj bote janë të limituara dhe të përkohshme, ndërsa begatitë e Botës Tjetër janë pa limit dhe të përhershme.

*Pyetja e dytë:* Përse Allahu thotë **“Bota Tjetër është më e mirë për ty”** dhe nuk thotë për ju?

Sepse mes njerëzve që e rrethonin Muhamedin kishte edhe të atillë që Bota Tjetër për ta ishte më e keqe se kjo jetë, në këtë kuptim në qoftë se Allahu do të përgjithësonte me siguri që kjo do të numërohej si një gënjeshtëri, por nga ana tjetër në qoftë se do të specifikonte persona të caktuar atëherë do të ekspozoheshin mëkatarët dhe hipokritët, prandaj Musai a.s tha **“Kurrsesi! Në të vërtetë, me mua është Zoti im. Ai do të ma tregojë rrugën”**. Surja el-Shuara:62, ndërsa Mahamedi a.s duke qenë se qe i shoqëruar nga një person që nuk kishte asnjë dyshim që do të ishte fatlum në Botën Tjetër tha **“Zoti është me ne”** Surja el-Teube:40, sepse këtu bëhet fjalë për profetin dhe besnikun.

Tregohet se Musai dhe mijëra njerëz morën të lutën tri ditë rrjesht që Zoti t’ju lëshojë shi nga qielli, por Zoti nuk iu përgjigj lutjes së tyre. Musai kërkoi të dinte arsyen që pengonte lutjen të pranohej dhe Zoti i tregoi që mes jush është një thashethemaxhi që s’lë njeri pa marrë në gojë. Musai i habitur pyeti kush është ai?! Unë e urrej një person të tillë, -ia ktheu Zoti, si mund të veproj njësoj si ai. Nuk kaloi shumë dhe shpallja i zbuloi Musait se thashethemaxhiu kishte vdekur, dhe se xhenazja e tij gjendet brenda në faltore. Musai shkoi me një frymë në faltore por aty gjeti shtatëdhjetë xhenaze. Dhe të mendosh që personi në fjalë ishte një mëkatar i pagdhendur dhe megjithatë Zoti nuk e demaskoi, po me miqt e Tij si do të sillet xhanëm?!

Duhet të meditojmë pak tani sepse këtu do të zbulojmë një hollësi, profeti a.s. ka thënë: *“Po të mos ishte për të moshuarit e përkulur do të derdhej mbi ju ndëshkimi”*, ky hadith është tregues i qartë i peshës së këtij ymeti, sepse në rastin e ymetit të Musait Zoti refuzon lutjen e mijëra njerëz për shkak të një mëkatarit, ndërsa në rastin e ymetit të Muhamedit për shkak të një besimtarit të ndershëm mëshiron të gjithë mëkatarët.

**“e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”** Surja el-Duha:5.

Janë dy aspekte të cilat shpjegojnë lidhjen e ngushtë të këtij ajeti me ajetin pararendës:

*Aspekti i parë:* Në ajetin pararendës Zoti i konfirmon Muhamedit se Bota Tjetër është më e mirë se kjo botë por nuk i tregon se sa është diferenca mes dy botëve, gjë të cilën e konfirmon në ajetin në fjalë, Bota Tjetër është më e mirë për ty sa të duash ti, pra derisa të kënaqesh.

*Aspekti i dytë:* **“Bota Tjetër është më e mirë për ty”**, në qoftë se do të pyesnim se përse është kështu, përgjigjja do të ishte kjo; sepse Zoti do t’i japë çdo gjë që dëshiron, gjë të cilën kjo botë nuk e përballon dot, mjafton kaq për të konfirmuar se Bota Tjetër është më e mirë se kjo botë. Në qoftë se e marrim të mirëqenë se premtimi i Zotit lidhet me Botën Tjetër, atëherë këtu bëhet fjalë ose për të mira materiale, siç thotë Abdulla ibn Abasi: Njëmijë kështjella të ndërhuara me perla të bardha, dheu misk, dhe shumëçka të kësaj natyre, ose për prestigj, që evokon privilegjin e ndërmjetësimin të madh. Thuhet se pasi u shpall ky ajet kuranor profeti a.s tha: *“Nuk do të kënaqem kurrë në qoftë se një anëtar i ymetit tim gjendet në zjarr”*. Dhe në fakt ky interpretimi bëhet i detyrueshëm për disa arsye:

*E para:* Zoti e urdhëron profetin të kërkojë falje **“Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët e besimtaret!”**

Surja Muhamed:19, dhe ne e dimë që pendimi është kërkesë, në këtë rast kërkesë për falje, dhe kush paraqet një kërkesë pret veç përgjigje, pra gjëja e vetme që e kënaq profetin është plotësimi i kërkesës, dhe në qoftë se është kështu me siguri që Zoti do t'ia plotësojë atë, atëherë bëhet e vërtetë kuptueshme që ky ajet kuranor është shpallur për ndërmjetësimin e profetit për besimtarët mëkatarë.

*E dyta:* Në pamje të parë ajeti kuranor jep të kuptohet pikërisht kjo gjë, sepse Zoti le të themi thotë që Unë nuk të kam braktisur as të urrej, madje unë nuk zemërohem me asnjë prej shokëve dhe pasuesve të tu sepse dua që ti të jesh i kënaqur dhe i lumtur, ky interpretim shkon përshtat me kuptimin e përgjithshëm të ajetit.

*E treta:* Janë të shumtë hadithet që marrin në trajtesë çështjen e ndërmjetësimit të cilat tregojnë në mënyrë indirekte se profeti do të kënaqet vetëm kur mëkatarët e ymetit të tij të jenë falur. Edhe ajeti në fjalë këtë gjë nënkupton, Allahu do ta kënaqë të dërguarin e tij, kjo gjë përftohet nga ajeti kuranor dhe hadithet profetike, pra ndërmjetësimi. Xhaferrri thotë se gjyshi im do të kënaqet vetëm atëherë kur në zjarr nuk do të mbesë asnjë anëtar monoteist i ymetit të tij.<sup>[1]</sup> Ndërsa el-Bakir thotë: Ithtarët e Kuranit thonë se ajeti më shpresëdhënës është ajeti 53 në Suren el-Zumer “**O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.**”, ndërsa ne Ehlu el-Bejti themi se ajeti më shpresëdhënës është në suren el-Duha “**e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.**”, për Zotin ky është ndërmjetësimi që do t'i mundësohet profetit për çdo monoteist deri sa të thotë jam i kënaqur.

Gjithë çfarë thashë më lartë merr kuptim në qoftë se pretendojmë se ajeti në fjalë merr të trajtojë çështjet e Botës Tjetër, por në qoftë se pretendojmë se ky ajet merr në trajtesë çështjet e jetës së kësaj bote atëherë nënkupton ngadhënjimin e profetit ndaj armiqve në luftën e Bedrit, ditën e çlirimit të Mekës dhe njerëzit që përqaftuan fenë turma turma. Gjithashtu dëbimi i fisit Benu Kurejdha dhe Benu Nedir, dërgimi i patrullave ushtarake në të gjitha qytet e rajonit, ngadhënjimi i kalifëve të drejtë, shembja e parandorive të tiranëve, zotërimi i pasurive mbretërore, pasiguria që pushtoi zemrat e perandorëve në Lindje dhe Perëndim dhe përhapja masive të fesë Islame. Megjithatë unë mendoj se ajeti në fjalë është më e përshtatshme të supozohet se ai merr në trajtesë të mirat e të dy botëve, dhe tani është momenti të bëj disa pyetje:

*E para:* Përse Zoti nuk shprehet në numrin shumë, pra do t'ju japë në vend të do të japë, sepse ne e dimë që edhe besimtarët përfitojnë gjithashtu nga këto begati bashkë me profetin?!

Mund të përgjigjem në disa mënyra:

*E para:* Premtimi përfshin edhe pasuesit e tij.

*E dyta:* Nëse i nderoj shokët e tu, kjo është në fakt nderim edhe për ty, sepse Unë e di që empatia jote arrin deri në atë pikë sa gëzohesh më shumë për ta sesa për veten. Ne e dimë që profetët atë ditë do të thonë: Shpirti im, shpirti im! Pra më intereson halli im pastaj halli i popullit tim, ndërsa ti do të thuash: populli im, populli im! Sepse ti do të ndjehesh i lumtur vetëm pasi t'i shikosh ata të lumtur në xhenet.

*E treta:* Marrëdhënia jote me Mua ishte e jashtëzakonshme, sepse kur të plagosën në fytyrë the “*O Zot udhëzoje popullin tim sepse ata nuk dinë!*”, ama kur të penguan të falësh namaz gjatë luftës së Hendekut the “*O Zot mbush barqet e tyre me zjarr!*”. Plagën që të shkaktuan në fytyrë e përballëve,

por nuk e përballove dot plagën që të shkaktun në besim, sepse namazi është çehrija e kësaj feje, pra ti më dhe përparësi Mua, prandaj Unë të ngrita mbi të tjerët, dhe përcaktova se kush e lë pas dore namazin, apo pengon dikë të falet, nuk do ta shpall mohues, por kush guxon të të prekë një qime floku e shpall pa asnjë hezitim mohues.

*Pyetja e dytë:* Çfarë dobie ka pjezësa ??? – seufe[2] – do të, dhe përse Zoti nuk shprehet me pjezësën e thjeshtëzuar ? – se – e cila ka të njëjtin kuptim?

Ka dy arsye mendoj unë:

*E para:* Përdorimi i pjezës në fjalë është shenjë e jetëgjatësisë së Muhamedit në këtë botë, pra exheli i tij nuk është afruar ende.

*E dyta:* Idhujtarët thanë Zoti e ka braktisur Muhamedin dhe e urren, ndërsa Allahu u përgjigj me të njëjtën gjuhë **“Zoti nuk të ka braktisur e as të urren”**, dhe mushrikët pas kësaj thanë, Muhamedi do të vdesë, dhe Allahu mori të përgjigjet sërish me të njëjtën gjuhë **“e Zoti yt do të japë sa të kënaqesh”**.

*Pyetja e tretë:* Si është e mundur që Zoti shprehet në vetën e tretë **“e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”**?

Është Xhibrili ai që po flet me Profetin a.s në këtë rast, meqenëse profeti a.s kishte mall të madh ta shikonte dhe të dëgjonte zërin e tij, prandaj Zoti zgjodhi që të jetë Xhibrili ai që do t’ia përcjellë këtë sihariq Muhamedit a.s.

*Pyetja e katërt:* Përse pjezësa ??? – seufe shoqërohet me një ? – *le* (lam)?

Kësaj pyetje i përgjigjet autori i librit el-Keshaf, ai thotë: Ky është *lam*-i nistor, që shërben për të konfirmuar kuptimin e fjalisë, por në këtë fjali mungon kryefjala e cila në fakt është e vëtkuptueshme, dhe kuptimi i ajetit në fjalë do të ishte “dhe në të vërtetë ty Zoti yt do të të japë” sepse nuk ka shpjegim tjetër, *lam*-i ka dy funksione; përdoret hem për të shprehur një betim por edhe si nistore, por ne e dimë se *lam*-i i betimit nuk përdoret dot para një folje në kohën e tashme me përjashtim të rastit kur shoqërohet me një ? – nun përforcues, në këtë kuptim mbetet të jetë përdorur si *lam* nistor, dhe ky i fundit përdoret veç para kryefjalës dhe kallzuesit, prandaj ajeti në fjalë shpreh të nënkuptuar kryefjalën. Dhe në qoftë se dikush ngre pyetjen se përse janë bërë bashkë dy pjezësa; njëra që përdoret si përforcuese ndërsa tjetra për të shprehur kohën e ardhme, do të përgjigjesha se kjo tregon që dhurata është e pashmangshme edhe nëse do të kërkojë shumë kohë, sepse edhe pritja `ka dobitë e veta.

**“A nuk ishte jetim e Ai të dha strehë?”**

Ky ajet përmban dy çështje të rëndësishme:

*E para:* Ky ajet ka lidhje logjike me ajetin pararendës, sepse kur ti ishte foshnje i pafuqishëm ne nuk të braktisëm, përkundrazi u sigurum për kujdesin dhe edukimin tënd, madje të ngritëm aq lart sa emri yt lexohet mbi bedenat e Arshit, dhe po të mos ishte për ty nuk do t’i krijoja planetet. Mendon se pas gjithë kësaj përkujdesjeje do të braktisim dhe hedhim poshtë?!



*E dyta:* A nuk të gjeti jetim nënkupton dijen, pra nuk e dinte Zoti se ti ishe jetim dhe të strehojë?! Megjithatë jepen dy komente të rëndësishme për fjalën jetim:

*I pari:* Tregohet se Abdulla Ibn Abdulmutalib ndërroi jetë ndërkohë që nëna e profetit ishte shtatëzënë. Profeti lindi jetim dhe që në përkujdesjen e gjyshit të tij Abdulmutalibit dhe nënës Emine. Edhe Emineja ndërroi jetë ndërkohë që djali i saj ishte gjashtë vjeç, kështu mbeti vetëm në përkujdesjen e gjyshit të tij. Dy vite më pas ndërroi jetë edhe gjyshi i tij, ky i fundit porositi Ebu Talibin të kujdeset për të, me qenë se Ebu Talib dhe babai i tij ishin vëllezër me të njëjtën nënë. Profeti kaloi në kujdestarinë e xhaxhait të tij deri sa i erdhi shpallja, ai e mbështeti dhe përkrahu për disa vite. Më pas ndërroi jetë edhe Ebu Talib dhe duket qartë se shenjat e të qenurit jetim nuk u shfaqën kurrë tek profeti a.s, pikërisht këtë begati të madhe Zoti ia vë në dukje.

Tregohet se Ebu Talibi i tha një herë vëllait të tij Abasit: Dëshiron të tregoj për Muhamedin çfarë kam parë prej tij? Sigurisht! -ia ktheu ai. E mbaja pranë vetes, nuk e lëshoja për asnjë çast gjatë natës apo ditës. Nuk i besoja askujt, madje e vija vetë në gjumë. Një natë i kërkova të zhvishej dhe të flinte me mua, por vura re një farë mospëlqimi në fytyrën e tij, megjithatë ai kujdesej të mos më binte në sy, dhe më tha: Xhaxha, ktheje fytyrën nga unë sa të zhvishem, sepse nuk duhet të më shikojë askush. U habita megjithatë i ktheva sytë derisa ai u zhvesh dhe ra në shtrat. Rashë edhe unë të fle, por vura re se mes meje dhe tij ishte një rrobë të cilën nuk e kisha vendosur unë, ishte shumë e butë dhe mbante erë të këndshme. U përpoqa ta shikoj Muhamedin por nuk shihja asgjë, dhe herë herë nuk e gjeja në shtrat, dhe sa herë merrja ta kërkoja më thoshte jam këtu, jam këtu. Sa herë uleshim për të ngrënë nuk e përmendnim emrin e Zotit dhe as e falenderonim pas tij, sepse ai sapo fillonte të hante thoshte: Me emrin e Allahut të vetmit, dhe kur përfundonte ushqimin thoshte: Lavdi Allahut! Unë veç habitesha me të. Asnjëherë nuk e kam dëgjuar të gënjejë, të qeshë kotë, të sillet keq a të dëfrehet me fëmijët.

*I dyti:* Fjala jetim përftohet nga një shprehje kulturore arabe që do të thotë xhevahir i vetmuar, pra, nuk të gjeti Zoti të vetmuar mes kurejshëve, të mundësoi kushtet ku mund të strehohesh, pra bëhet fjalë për Ebu Talibin. Por folja ??? – ava vjen me dy kuptime: vjen me kuptimin strehoj, por vjen edhe me kuptimin mëshiroj, dhe këtu na lindin dy pyetje:

Pyetja e parë: Si mundet që Bujari i madh të begatojë duke thënë **“A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?”** gjë të cilën e përforcon fakti se Zoti tregon se **“Faraoni tha: “Vallë, a nuk të kemi rritur në gjirin tonë si fëmijë?! A nuk ke qëndruar midis nesh shumë vjet të jetës sate?!”** Surja el-Shuara:18, dhe ky ajet vjen si kritikë e hapur për Faraonin, dhe në qoftë se Faraoni kritikohet sepse veprimi i tij konsiderohet i ulët, e njëjta sjellje si mund të konsiderohet e mirë kur bëhet fjalë për Zotin?!

Po, sigurisht që do të ishte një veprim i mirë në qoftë se përmes tij do të synonte ta bënte të qëndrueshëm dhe ta parapërgatisë për begatitë e përjetshme. Tani e kemi të lehtë të dallojmë dy sjelljet, atë të Zotit dhe të Faraonit, kjo e fundit është zhgënjyese, poshtëruese, sepse synon shfrytëzimin, ndërsa sjellja e Zotit është begatuese. Le të themi se Zoti thotë: si mund të mos i mbash shpresat tek Unë, ndërkohë që Unë të kam edukuar dhe jam përkujdesur për ty që fëmijë, mendon vallë se do të braktis tani?! Sigurisht që jo, përkundrazi, Unë do ta plotësoj begatinë time për ty dhe ymetin tënd, **“që të plotësoj mirësinë Time”** surja el-Bekare: 150. Me siguri ka dallim të madh mes përkujdesjes së Zotit dhe asaj të Faraonit, është njësoj si të thuash **“Ata ishin tre veta ndërsa qeni i katërti”** surja el-Kehf:22, dhe **“Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti.”** Surja el-Muxhadele:7, kur bëhet fjalë për ymetin e Muhamedit. Pra, ka dallim mes një populli që i katërti është qeni i tyre, dhe një populli që i katërti është Zoti i tyre.

Pyetja e dytë: Zoti e nderoi Muhamedin tri herë, pastaj e nxiti të kujtojë mirësitë e Zotit, ekziston ndonjë lidhje logjike mes tyre?!

Me siguri që po, le të themi se shlyerja e borxhit është detyrim, megjithatë borxhi mund të jetë dy lloje: monetar dhe moral, dhe është e sigurtë që lloji i dytë është edhe më i rëndë, sepse nga borxhi monetar mund të lirohesh në qoftë se huadhënësi ta fal atë, ndërsa ai moral në këtë mynyrë bëhet edhe më i rëndë. Borxhi monetar shlyhet një herë dhe shpëton përgjithmonë, ndërsa ai moral të shoqëron gjithë jetën. Dhe në qoftë se nuk mund ta shlyesh një borxh moral ndaj një krijese të dobët si njeriu, si mund ta shlyesh atë ndaj Zotit Madhështor?!

**“A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi?”**

Ka njerëz që pretendojnë se profeti a.s. ka qenë idhujtar si pjesa tjetër e shoqërisë arabe, por Allahu lëshoi dritën e udhëzimit në zemrën e tij dhe e përzgjodhi profet. Këtë pretendim e mbështet el-Kelbi i cili tek komenton këtë ajet thotë: “Pra Zoti të gjeti mohues në një shoqëri të devijuar dhe të udhëzoi në monoteizëm. el-Sedi thotë se Muhamedi ka qenë dyzet vite pjestar i fesë së shoqërisë së vet. Zoti të gjeti të devijuar nga udhëzimi thotë Muxhahid. Dhe për të mbështetur këtë pretendim ata bazohen në disa ajete kuranore **“Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç’është besimi.”** Surja el-Shura:52, dhe **“ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë.”** Surja Jusuf:3, dhe **“Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen”** Surja el-Zumer:65.

Por pjesa më e madhe e dijetarëve janë të bindur se profeti a.s. nuk ka qenë për asnjë çast të jetës së tij idhujtar.

Ndërsa shkolla mutezilite ka një pretendim të tretë. Ata thonë se pretendimi që profeti kurrë nuk ka qenë idhujtar është logjikisht i pamundur, sepse një gjë që logjikisht është e mundur nuk ka arsye ta konsiderojmë të pamundur, pra logjikisht është e mundur që një person të ketë qenë mohues dhe Zoti e ushqen me dritën e besimit dhe e zgjedh profet, por për rastin në fjalë kemi një fakt kuranor që e mohon mundësinë të ketë ndodhur një gjë e tillë që është logjikisht e mundshme, sepse Zoti thotë: **“Shoku juaj (Muhamedi a.s.), nuk ka humbur e nuk ka devijuar!”**, Surja el-Nexhm, ajeti 2.

Dijetarët kanë dhënë interpretime të shumta për këtë ajet kuranor:

**Interpretimi i parë:** Ai të gjeti të pavëmëndshëm dhe larg shenjave të mirësisë dhe dispozitave të

shariatit, dhe të orientoi, mendon Abdullah ibn Abasi, el-Hasen, Dahaku dhe Shehr ibn Hausheb, ky është edhe kuptimi i fjalës së Allahut “**Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç’është besimi.**” Surja el-Shura:52, dhe “**ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë.**” Surja Jusuf:3.

**Interpretimi i dytë:** Halimja vendosi ta kthejë tek gjyshi i vet Muhamedin, por kur u afruan në qytet ai humbi nga sytë e asaj, dhe Halimja mori t’i ankohet Hubelit[3], por idhujt ranë përtokë. Aty dëgjoi edhe një zë që thoshte: Ky djalosh do të na shkatërrojë. Kjo është një histori e gjatë në fakt.

**Interpretimi i tretë:** Transmetohet se profeti ka thënë: Një herë kur isha i vogël humba rrugën dhe gjyshi im nuk la vënd pa më kërkuar, gati sa s’vdiqa nga uria dhe Zoti më orientoi. Tregohet se Abdulmutalibi u var tek mbulesa e Qabesë dhe u lut:

Muhamedin, djalin tim o Zot kthema

Ktheje Zot im ta kem krah

Abdulmutalibi vazhdoi të lutej derisa u shfaq Ebu Xhehli dhe bashkë me të Muhamedi mbi deve. Nuk e di ç’po ndodh me djalin tënd?! -tha Ebu Xhehli. Përse e thua këtë? -ia ktheu Abdulmutalibi. Po ja, unë e ula devenë që të hipim mbi të, hipa unë dhe Muhamedi pas meje por ajo refuzoi të çohet. E hipa Muhamedin para dhe ajo u çua menjëherë. (Sikur donte të thoshte, o budalla ai është prijës, si mund të rrijë mbrapa?!). Abdullah ibn Abasi ka thënë: Zoti e ktheu Muhamedin tek gjyshi i tij me duart e armikut të tij, njësoj siç veproi me Musain, të cilin e mbrojt me duart e armikut të vet.

**Interpretimi i katërt:** Profeti a.s. udhëtoi bashkë me shërbëtorin e tij, Mejseran, dhe një pabesimtar mori frerët e devesë dhe u nisën për udhëtim por humbën rrugën. Allahu dërgoi Xeibrilin në trajtën e një njeriu dhe i orientoi drejt karvanit. Thuhet gjithashtu se Ebu Talib udhëtoi bashkë me të drejt Shamit por humbën rrugën dhe Allahu i orientoi.

**Interpretimi i pestë:** Pra ti ishe i rrethuar nga mohuesit në Mekë por Zoti të bëri të fortë që t’u demonstrosh atyre epërsinë e fesë tënde.

**Interpretimi i gjashtë:** Arabët pemën e vetmuar në një tokë të shkretë e quajnë ???? – daletun – e humbura, pra le të themi se Zoti dëshiron të thotë se ai vend ishte aq i shkretë sa nuk gjendej asnjë pemë që prodhonte fruta besimi përveç teje. Pra ti je një pemë e rrallë në shkretëtirën e injorancës, Unë të gjeta të humbur dhe përmes teje udhëzova njerëzimin. Një kuptim të ngjashëm mbart thënia e profetit a.s. “**Urtësia është synimi i lartë i besimtarit.**”

**Interpretimi i shtatë:** Të gjeti larg njohjes së Zotit kur ishe i vogël, siç thotë Zoti në Kuran “**Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë**” Surja el-Nahël:78, por Zoti të pajisi me intelekt, dhe të dha udhëzim dhe njohje. Pra fjala ??? – dalun – në këtë kontekst merr kuptimin i zbrazur nga dija, por jo një dije e gabuar.

**Interpretimi i tetë:** Ishe i painformuar për profecinë, nuk e aspiroje një gjë të tillë dhe as e kishe çuar ndonjëherë ndërmend. Hebrenjtë dhe të krishterët pretendonin se profecia do të ndahej mes bijve të Izrailit, por unë të përzgjodha profet, gjë të cilën nuk e kishe aspiruar kurrë.

**Interpretimi i nëntë:** Ndoshta Zoti i drejtohet të parit të vendit dhe ka për qëllim popullin e tij, pra e

gjeti popullin tënd të paudhëzuar dhe e udhëzoi përmes teje dhe shariatit tënd.

**Interpretimi i dhjetë:** Ai të gjeti të larguar nga të devijuarit, të vetmuar dhe larg fesë së tyre. Sa më shumë largohesh prej tyre, aq më shumë thellohej devijimi i tyre, dhe Zoti të udhëzoi të qëndrosh me ta dhe t'i ftosh në fenë e vërtetë.

**Interpretimi i njëmbëdhjetë:** Zoti të gjeti të pafuqishëm për hixhret, të hutuar në duart e kurejshëve dhe me dëshirën e zjarrtë për t'u ndarë me ta, gjë të cilën nuk guxoje ta bëje pa lejen e Tij. Dhe kur të dha leje dhe miku yt u pajtua me ketë dhe të orientoi tek çadra e Umu Mabadit. Pastaj ndodhi çfarë ndodhi me Surakën dhe feja jote dominoi dhe shfaqti forcën, kjo gjë nënkuptohet nga thënia e tij: "dhe të udhëzoi".

**Interpretimi i dymbëdhjetë:** Ti kishe humbur drejtimin e kiblesë por shpresa që Qabeja një ditë të bëhej qendra e orientimit nuk të ishte shuar kurrë, dhe Zoti të udhëzoi me dekret hyjnor **"Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty"** Surja el-Bekare:144, dhe le të themi se këtë hutim Zoti e quan humbje.

**Interpretimi i trembëdhjetë:** Kur iu shfaq Xhebraili për herë të parë, ai nuk e dinte nëse ishte Xhebraili apo jo, dhe u frikësua aq shumë sa mund të hidhej nga ndonjë mal i lartë, por Zoti e udhëzoi që ta njohë Xhebrailin.

**Interpretimi i katërbëdhjetë:** Kjo shprehje në këtë rast merr të njëjtin kuptim me fjalën e Allahut në suren Jusuf, ajeti: 95 **"Për Allahun, me të vërtetë, ti edhe tani qëndron në gabimin e mëparshëm"**, pra dashurinë, që do të thotë ngaqë ti më do Unë të udhëzova dhe të tregova **rrugën që të afron më shumë me të dashurin tënd.**

**Interpretimi i pesëmbëdhjetë:** Pra ishe i parratur me problemet e kësaj bote, pa eksperiencë në fushën e tregëtisë, ndërsa Unë të frymëzova si të bëhesh një tregtar i famshëm, sa vetë Hatixheja kërkoi të martohet me ty.

**Interpretimi i gjashtëmbëdhjetë:** Të gjeti të humbur mes shoqërisë e cila të lëndonte por të dha forcë dhe udhëzim derisa u bëre i pari i vendit.

**Interpretimi i shtatëmbëdhjetë:** Kishe humbur udhën e qiejve ndërsa Unë të udhëzova dhe të ngjita mbi shtatë qiej natën e Miraxhit.

**Interpretimi i tetëmbëdhjetë:** Të gjeti të humbur vjen me kuptimin të harruar, siç thotë Zoti në Kuran në suren el-Bekare, ajeti:282 **"nëse njëra grua harron, t'ia kujtojë tjetra"**<sup>[4]</sup>, dhe Unë të udhëzova pra të kujtova, sepse profeti a.s. në fakt Natën e Miraxhit për shkak të madhështisë së prezencës hyjnore harroi çfarë duhet të thoshte dhe Zoti ia kujtoi, ndërsa ai tha: *"Nuk mund ta shpreh dot sa shumë lavd meriton!"*

**Interpretimi i nëntëmbëdhjetë:** Edhe pse me siguri profeti e njihte me zemër Zotin, vetëm se ai nuk e shfaqte një gjë të tillë në shoqërinë e tij, gjë të cilën Zoti e quan devijim.

**Interpretimi i njëzet:** Aliu tregon se profeti a.s. ka thënë: Nuk kam aspiruar kurrë të përfshihem në eventet e shoqërisë së periudhës së xhahilijetit me përjashtim të dy rasteve, megjithatë Zoti më pengoi dhe nuk u përfshiva. Pastaj nuk mendoja më për gjëra të tilla derisa Zoti më nderoi me profecinë.

Profeti a.s. tregon: “Një natë i thashë një djaloshi kurejshit, i cili kulloste me mua bagëtitë në kodrinat e Mekës, m’i ruaj delet sot sepse dua të shkoj në Mekë e të kaloj natën atje ashtu siç kalojnë të rinjtë. Sapo iu afrova shtëpive të para të Mekës dëgjova zhurmën e dajreve dhe melodinë e fyejve. Filani, djali i filanit, po martohet me filankën, -dëgjohej një zë i lartë. U ula të shikoj por Zoti m’i mbylli veshët dhe më mori gjumi. Po të mos ishte për rrezet e diellit që më dogjën në mëngjes askush nuk do më zgjonte. U ktheva tek shoku im dhe ai më pyeti: Çfarë bëre? Asgjë, -ia ktheva unë, pastaj i tregova se çfarë më ndodhi. Të nesërmen i kërkova të njëjtën gjë dhe sërish më zuri gjumi dhe u zgjova në mëngjes për shkak të rrezeve të diellit, pastaj nuk mendova më për gjëra të tilla derisa Zoti më nderoi me profecinë.

**“A nuk ishte nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?”** Surja el-Duha:8

Rreth këtij ajeti kuranor më duhet të sqaroj disa çështje:

*E para:* Fjala ????? – aillun e përdorur në këtë ajet kuranor do të thotë njeri në nevojë. Ne e kemi trajtuar këtë gjë edhe më herët kur komentuar ajetin e tretë në suren el-Nisa. Kjo shprehje vjen edhe në ajetin 28 të sures el-Teube **“mos kini frikë nga varfëria”**. Pra shprehja ????? – el-ailu përdoret rëndom për fukarain. Ekzistojnë dy komente të rëndësishme për këtë fjalë:

*Komenti i parë:* Që është edhe komenti më i përhapur fjala el-Ailu domethënë nevojtar, pra të gjeti nevojtar dhe të pasuroi. Duhet të kemi parasysh se pasurimi në këtë kontekst mund të marrë kuptime të ndryshme.

*Kuptimi i parë:* Ai nuk kishte nevojë për asgjë me qenë se Zoti e kishte lënë nën kujdesin e Ebu Talibit, dhe kur u përkeqësuan kushtet e Ebu Talibit, Zoti e mbështeti me pasurinë e Hatixhes, kur ajo nuk e ndihmoi dot më, Zoti e mbështeti me pasurinë e Ebu Bekrit, dhe kur ai nuk mundej më Zoti e urdhëroi të emigrojë dhe e mbështeti me përkrahjen e ensarëve. Pastaj e urdhëroi për xhihad dhe e pasuroi me plaçkën e luftës. Edhe pse ne e dimë se urdhëri për xhihad vjen pa kësaj sure, megjithatë përderisa ne e dimë se kjo gjë do të ndodhte le të themi është njësoj sikur ka ndodhur. Tregohet se ai një herë shkoi tek Hatixheja i dëshpëruar, ajo e pyeti: Çfarë të ka ndodhur? Është kohë thatësire, -ia ktheu ai, -nëse shpenzoj para, do të më mbarojë pasuria jote, dhe më vjen turp prej teje, e nëse nuk shpenzoj, druhem prej Zotit. Ajo ftoi menjëherë kurejshët, dhe mes tyre ishte edhe Ebu Bekri, i cili solli dinarë dhe i derdhi para këmbëve. Ishin aq shumë sa nuk mund ta shihja atë që ishte ulur përballë meje, -thotë Ebu Bekri. Pastaj ajo tha: Dëshmoni se këto para janë të tijat, nëse do, mund t’i ndajë dhe nëse do, mund t’i mbajë!”

*Kuptimi i dytë:* Zoti e pasuroi me shokët e tij të cilët faleshin fshehurazi. Kur përqafoi Umeri Islamin tha: Ata adhurojnë publikisht Latin<sup>[5]</sup> ndërsa ne ta adhurojmë fshehurazi Allahun?! Profeti a.s. i tha: Le të presim sa të shtohet numri ynë. Umeri ia ktheu: Mjafton që ke përkrahjen e Zotit dhe timen, ndërsa Allahu shpalli **“O Profet! Allahu të mjafton ty dhe besimtarëve që të pasojnë.”** Surja el-Enfal:64. Pra Zoti i dha përkrahje Muhamedit me pasurinë e Ebu Bekrit dhe personalitetin e Umerit.

*Kuptimi i tretë:* Zoti të pasuroi me një shpirt të vetëkënaqur dhe vetëpërmbytur, sa ari dhe guri vlenin njësoj për ty. Në zemrën tënde gjeje veç dashuri për Zotin, dhe Zoti në fakt ka si atribut vetëmjaftueshmërinë, dhe ngaqë është i Vetëmjaftueshëm është absolut, pra është Absolut prej të qenurit i vetëmjaftueshëm jo prej tyre. Ndërsa ti prej të qenurit i vetëkënaqur hoqe dorë nga gjërat, dhe kjo është pasuria më e madhe në fakt, të jesh i plotësuar pa gjërat jo me gjërat. Madje profetit iu bë një ofertë, të zgjedhë mes pasurisë dhe varfërisë, dhe ai zgjodhi të dytën.

*Kuptimi i katërt:* Kishe nevojë për fakte dhe argumente dhe Zoti të shpalli Kuranin dhe të mësoi çfarë nuk ke ditur.

*Komenti i dytë:* Ti je i rrethuar nga njerëz të afërm ata janë ymeti yt, kjo mjafton për ty. Madje thuhet se Allahu i pasuroi ata përmes teje sepse ata qenë të varfër kulturalisht ndërsa ti ishe vatra e dijes, dhe prej teje ata u udhëzuan.

Tani është momenti të bëj disa pyetje:

*E para:* Fakti që Zoti zgjodhi që ai të jetë jetim përmban ndonjë urtësi? Do të jap disa përgjigje:

*Përgjigjja e parë:* Që profeti ta vlerësojë si duhet statusin e jetimit, në mënyrë që t'i japë hakun dhe t'i ruajë interesat e tij. Thuhet se Jusufi kurrë nuk është ngopur me ushqim, ai tha: nuk dua të ngopem sepse kam frikë se harroj urinë.

*Përgjigjja e dytë:* Që jetimi ta ndajë këtë status me vetë profetin a.s. dhe për hatër të tij të nderohet. Profeti a.s. ka thënë: “Në qoftë se e emërtoni djalin tuaj Muhamed atëherë nderojeni dhe bëjini vend të posaçëm në mexhlis.”

*Përgjigjja e tretë:* Është e vetëkuptueshme dhe normale që fëmijët të jenë të varur nga prindërit e tyre, por Zoti i mori herët që të dy prindërit e profetit a.s. që të mbështetej veç tek Ai. Në këtë mënyrë si fëmijë do të ngjante me Ibrahimin a.s i cili tek u lut tha “Fakti që Ai ma di hallin mjafton për lutjet e mia”. Dhe përgjigjja e Merjemes “**Nga të vjen ky ushqim?**” **Ajo përgjigjej: “Ky është nga Allahu”** Surja Al Imran:37.

*Përgjigjja e katërt:* Zakonisht të metat e jetimit nuk mbahen fshehur por shfaqen, për këtë arsye ndoshta Zoti zgjodhi të jetë jetim që çdokush të kishte akses dhe ta dinte nëse ka apo jo ndonjë të metë, në këtë mënyrë do të pajtohen për integritetin e tij moral para parafecisë që të mos kenë arsye ta bëjnë një gjë të tillë pas saj.

*Përgjigjja e pestë:* Zoti bëri që ai të jetë jetim në mënyrë që të jetë veç në përkujdesjen e Tij, sepse ne e dimë që po të ishte babai i tij gjallë do të kujdesej për të.

*Përgjigjja e gjashtë:* Të qenurit jetim dhe fukara është një disavantazh i madh për njerëzit, por Muhamedi edhe pse i kishte të dyja këtotribute u shpall krijesa më e lavdishme, dhe në këtë kuptim këtë mund ta numërojnë edhe një lloj mrekullie.

*Pyetja e dytë:* Cila është arsyeja që Zoti i përmendi këto fakte?

Që Muhamedi të mos harrojë asnjëherë si ka qenë sepse kjo do të ishte arsye për ta shtyrë në arrogancë.

*Pyetja e tretë:* Tregohet se profeti a.s. ka thënë: “Një herë i kërkova Zotit diçka për të cilën u bëra pishman dhe do kisha dashur të mos ia kërkoja kurrë. I thashë: Ibrahimin e zgjodhe mik të ngushtë, Musait i fole drejtpërdrejt, Daudit ia nënshtrove malet ndërsa Sulejmanit i dhe këtë e atë. Ndërsa Ai ma ktheu: A nuk ishe jetim e të dhashë strehë? A nuk të gjeta të paditur e të udhëzova? A nuk ishe nevojtar e të bëra të mos ia kesh nevojën askujt? Padyshim o Zot! -ia ktheva unë. Pastaj më tha: “Vallë, a nuk ta hapa kraharorin? Sigurisht o Zot! -ia ktheva unë. “Nuk ta ngrita lart emrin?! Sigurisht o Zot! Pastaj më tha: “Nuk ta hoqa barrën?! Po! Sigurisht o Zot! Nuk të dhurova çfarë nuk ia kam dhuruar asnjë profeti para teje, ajetet e fundit të sures el-Bekare?! Nuk të kam trajtuar si mik të ngushtë ashtu si edhe Ibrahimin?! Është e vërtetë kjo ngjarje?”

El-Kadi shprehet se kjo ngjarje nuk është e vërtetë, sepse profetët nuk mund të kërkojnë gjëra të tilla, aq më pak profeti ynë gjë që nxit qortimin e Zotit.

**“Prandaj, mos e shtyp jetimin”** Surja el-Duha:9.

Ekziston një mendim se folja ????? – *takhar* shqiptohet me “T” të butë ?????, por në këtë rast do të thotë vrenjtem, pra mos e vrenjt fytyrën para jetimit. Gjithsesi kuptimi i ajetit është; trajtoje jetimin njësoj siç të trajtoi Zoti ty. Një ajet i ngjashëm është edhe ai në Suren el-Kasa,<sup>77</sup> **“Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu.”** E ngjshme me këtë është edhe vetë thënia e profetit a.s.

*“Në emër të Allahut silluni mirë me atë që s’ka asnjë përkrasë veç Allahut”.* Thuhet gjithashtu se ky ajet është shpallur në momentin që profeti qortoi djaloshin e Hatixhesë. Tregohet gjithashtu se Musai e pyeti Zotin si arriti këtë gradë kaq të lartë tek Ty, dhe Ai i tha: Të kujtohet qengji i cili u end gjithandej, të cilin e mbajte hopa kur e gjete?! Kjo ishte arsyeja pse të bëra mëkëmbës për njerëzimin. Në qoftë se Musai e arriti këtë detyrë fisnike sepse u soll mirë me një qengj, çfarë mund të arrijë dikush që sillet mirë me jetimin?! Dhe në qoftë se kritika këtu bëhet thjesht për shprehjen e fytyrës çfarë mund të themi për kë e poshtëron apo ha pasurinë e tij padrejtësisht. Enesi transmeton se profeti a.s. ka thënë: “Kur qan jetimi lotët e tij pikojnë në dorën e Mëshiruesit, dhe Zoti thotë: Kush e bëri të qajë këtë jetim, babain e të cilit e ka mbuluar dheu? Kush ia pushon lotët fiton xhenetin!”

**“Ndërsa lypësin mos e shtyp me ashpërsi”** Surja el-Duha:10.

Ekzistojnë dy komente të rëndësishme për domethënien e fjalës lypës:

*I pari:* Fjala ??????? – lypës vjen me kuptimin e kërkuesit të dijes, këtë tezë e mbështet el-Hasen, dhe një ajet i ngjashëm që mbështet këtë tezë është ai në suren el-Abese, **“Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin, kur i erdhi pranë i verbri.”** Veç ky interpretim mundëson ruajtjen e rendit të ajeteve, 6,7 dhe 8, si edhe porositë që shkojnë në harmoni të plotë në ajetet që vijojnë, 9,10 dhe 11. Sepse në ajetet 6,7 dhe 8 Zoti thotë: **“A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur e të udhëzoi? A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?,** dhe renditjen e ruan në mënyrë perfekte në ajetet në vazhdim tek e porosit së pari të kujdeset për jetimin, së dyti t’i përgjigjet atij që kërkon dije dhe udhëzim, dhe së treti të tregohet mirënjohës ndaj Zotit për begatitë e shumta.

*I dyti:* Fjala ?????? – lypës vjen me kuptimin e fukarait, dhe janë tre vende në Kuran ku Zoti e qorton profetin për fukarenjtë.

*Rasti i parë:* Profeti ishte një herë i rrethuar nga paria kurejshite, ndërkohë i afrohet Ibn Umi Mektum, një person i verbër, ai kaloi mospërmas njerëzve dhe u ul pranë profetit a.s. dhe i tha më mëso ato gjëra që të ka mësuar Allahu. Kjo gjë e bezdisi disi profetin a.s. dhe u vrenjt, për këtë arsye Zoti shpalli **“Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin”** Surja Abese:1.

*Rasti i dytë:* Tregohet se kurejshët kërkuan që profeti a.s. ta ndajë mexhlisin e tyre nga ai i fukarenjve dhe në një farë mënyrë profeti gati sa nuk ia dëgjoi fjalën atyre, por Zoti shpalli **“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar kënaqësinë e Tij”** Surja el-Kehf:28.

*Rasti i tretë:* Osmani i solli një bistak frutash dhe ndërkohë që profeti mori të hajë dikush troket derën. E mëshiroftë Zoti atë që na mëshiron!, -u dëgjua pas dere zëri i trokitësit. Profeti i kërkoi Osmanin t’ia japë lypësit bistakun, por Osmani u duk i mërzhitur, sepse dëshironte ta konsumonte profeti. E ndoqi lypësin nga pas, pasi ai u largua dhe ia bleu bistakun dhe u kthye tek shtëpia e profetit a.s. dhe ia dha sërish atë, dhe këtë veprim e përsëriti tri herë, sepse lëpysi për çdo rast kthehej dhe trokiste derën e profetit dhe ai ia dhuronte sërish, derisa në fund i tha: Ju jeni lypës apo tregtar?, ndërsa Zoti shpalli **“Ndërsa lypësin mos e shty me ashpërsi”** Surja el-Duha:10.

**“dhe dhuntitë e Zotit tënd shpalli”** Surja el-Duha:11.

Këtu kemi disa komente në lidhje me fjalën ?????? – *el-Nimetu* -begatia, mirësia, dhuntia.

*Komenti i parë:* Muxhahid pretendon se begatia në fjalë është Kurani, sepse Kurani është begatia më e madhe që Zoti i dhuroi Muhamedit, dhe mënyra se si ai mund ta shprehë atë është ta lexojë dhe t’ia lexojë të tjerëve dhe të tregojë të vërtetat e tij.

*Komenti i dytë:* Na vjen sërish nga Muxhahid i cili gjithashtu pretendon se begatia në fjalë është profecia, pra përcillja njerëzve mesazhin që të ka dhënë Zoti.

*Komenti i tretë:* Në qoftë se Zoti të jep sukses të kujdesesh për jetimin dhe të ndihmosh nevojtarin, sukses i cili me siguri që është një begati e madhe prej Zotit, atëherë shpalle atë që shembullin tënd ta ndjekin edhe të tjerët. Hysen Ibn Ali thotë: Kur të bësh një vepër të mirë tregojua miqve ndoshta ndjekin shembullin tënd, me kusht që kjo gjë të mos nxisë syfaqësi.

E pyetën Aliun r.a. për shokët e tij, dhe ai u shpreh me superlativa për ta, njerëzit i kërkuan të flasë pak për veten, por ai refuzoi duke u argumentuar se Zoti e ndalon lavdërimin e vetes. Por ata këmbëngulën duke i kujtuar ajetin kuranor **“dhe dhuntitë e Zotit tënd shpalli”**. Do të flas atëherë, -tha ai. Kur dikush më lutet unë i jap, dhe kur hesht e ndihmoj, në mes kraharorit tim gjendet një dije shumë e madhe kështu që pyesni sa të doni.

Në qoftë se dikush pyet se cila është arsyeja që Zoti të drejtën e vet e rendit pas hakut të jetimit dhe nevojtarit, unë do të thojë se kjo vjen për tri arsye:



*E para:* Le të themi se në këtë mënyrë Zoti dëshiron të thotë se Unë jam i pasur absolut ndërsa ata janë nevojtarë, në këtë kuptim ata kanë prioritet.

*E dyta:* Për nevojën e tyre Zoti nxit veprën, ndërsa për vete kënaqet edhe me fjalë.

*E treta:* Qëllimi i të gjitha adhurimeve është kridhja e zemrës në emrin e Zotit, në këtë kuptim Zoti i përmbyll këto akte adhurimi me aktin e zemrës dhe shprehjes me gjuhë begatitë e Zotit, që të gjitha aktet e adhurimit të finalizohen me përkujtimin e Zotit. Dhe Zoti zgjodhi foljen ??? – hadith – shprehu, në mënyrën urdhërore, në vend të foljes ??? – habir – njofto, që të shndërrohet në një ligjërim të gjallë që nuk harrohet, dhe që do përsëritur herë pas here.

Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin për profetin Muhamed, familjen dhe shokët e tij!

## Shënime

[1] Arabët paraardhësin e tyre mashkull të trungut familjar e emërtojnë gjysh edhe nëse është brezi i katërt e sipër.

[2] Gjuha arabe për të ndërtuar kohën e ardhme mbështetet në foljen e kohës së tashme duke i shtuar kësaj të fundit parashtesën foljeformuese ? – se ose ??? – seufe, që të dyja shërbejnë për të formuar kohën e ardhme, por ndërsa njëra përdoret si parafjalë stadarde për të ndërtuar kohën e ardhme, tjetra përdoret për të njëjtën arsye por me diferencën se ??? – seufe shërben për një kuptim ekstra, pra nuk bëhet fjalë thjesht për kohën e ardhme por për një fenomen që do të ndodhë në të ardhmen e largët, pra ka një diferencë konceptuale mes tyre. Në Kuran përdoret kryesisht për ngjarjet e Botës Tjetër, që shkon përshtat me funksionin e saj gramatikor.

[3] Një hyjni paraislame që paraqitej nga një idhull në Qabe, i cili u shkatërrua nga Muhamedi kur ky pushtoi Mekën në vitin 630. Mbrojtësi i Kurejshëve, fisit udhëheqës të Mekës. John Esposito, Fjalori i Oksfordit për Islamin, fq/139

[4] Zoti në këtë ajet përdor foljen ?? – dal-le që do të thotë humb, devijon, që është nga e njëjta rrënjë fjale më emrin ??? – dalun e përdorur në suren el-Duha, por që në këtë rast vjen me kuptimin harroj.

[5] Lat Një nga tre perëndeshat paraislame që adhuroheshin në Qabe në Mekë, para shfaqjes së Islamit. Emri do të thotë “perëndeshë”. Identifikohej si “vajzë e hyut”, meqë supozohej të ishte pasardhëse e martesës së hyut me një xhin, por ajo mund të jetë konsideruar edhe si bashkëshorte e hyut. Zakonisht paraqitej në formë njerëzore. Idhulli që e paraqiste atë u shkatërrua në vitin 630, kur Muhamedi dhe muslimanët pushtuan Mekën. Denoncohet në Kuran (53: 19-20) John Esposito, Fjalori i Oksfordit për Islamin, fq/195.

## Date Created

10/11/2023

## Author

erasmusi